



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

**Procesverbali i mbajtur në takimin në debat me qytetaret rrëth Rregullores së punës së Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani", mbajtur më datën 10.05.2021**

Takimi filloin në orën 14.00, ashtu siq ishte e planifikuar, takimi u mbajtë në sallen e asambles komunale në Komunën e Podujevës, fillimisht shpreh falëndërimet sa i përket interesimit lidhur me rregulloren e punës dhe i falenderoj të gjithë të pranishmit dhe para pjesëmarrësve prezanton Drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit znj. Elhame Kutllovci.

Pjesmarrësit tjerë në këtë takim janë evidentuar dhe nënshkruar në listen për pjesmarrje e cila është pjesë e këtij procesverbali.

**Tema: Dëgjimi publik rrëth Rregullores së punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani".**

Takimin e hapi drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Podujevës znj. Elhame Kutllovci, e cila shpjegoi bazën ligjore të rregullores dhe fushat të cilat ajo i ka në fushëveprim.

Ajo prezantimin e filloi duke i uruar mireseardhje në takimin për të bashkëbiseduar lidhur me projekt rregulloren e punës së këshillit drejtues të teatrit "Avdush Hasni" në Podujevë, ajo shpalosi pikat duke filluar nga: Dispozitat e përgjithëshme, përbërjen e këshillit drejtues, përgaditjen dhe thirrjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues, udhëheqjen e punës dhe vendosja në mbledhje, shkarkimin e drejtoreve, procesverbalët e takimeve si dhe kompenzimit monetar për punën e këshillit.

"Kjo Rregullore, bazohet në Ligjin për Teatrot dhe Statutin e Teatrit "Avdush Hasani". Ndërsa rregullon funksionimin dhe perjegjesitë e ekzekutivit karshi teatrit, po ashtu përcakton edhe mënyrat e funksionimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit tjetër të Teatrit.

Drejtoresha Kutllovci tha se orientimi i saj është që Teatri të veprojë si institucion i pavarur.

"E komunës, përkatesisht, drejtorisë është sigurimi i mekanizmave për funksionimin e mirë të Teatrit dhe bazë për funksionimin, mbarëvajtjen dhe

gjithçka tjeter do të jetë kompetencë e Këshillit Drejtues, drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorit artistik që parashihet të caktohet në bazë të kësaj rregulloreje" tha drejtoresha Kutllovci.

Drejtoresha Elhame Kutllovci e hapi diskutimin për antarët pjesmarrës:

Fjala e mori Drejtori i Teatrit "Avdush Hasani" z.Agron Gërguri, fillimisht shprehi falenderimet dhe përgëzoj për iden e punimit të kësaj rregullore se kjo rregullore e kompleton hierarkinë e teatrit me të gjitha trupat e veta.

Ai potencozi se mbështet funksionalizimin dhe kompletimin e infrastrukturës ligjore për Teatrin "Avdush Hasani" dhe së bashku me komunitetin e njerëzve të artit do të jepin kontribut për hartimin e saj në secilën fazë.

Për Rregulloren në fjalë, gjatë diskutimit të tyre ide dhe komente dhanë edhe pjesëmarrësit tjerë në debat publik.

Pas fjalet së Drejtorit të Teatrit "Avdush Hasani" z. Agron Gërguri, kaloj nga ana e një aktori z.Sabit Zeneli, ku potencozi përgëzimet për implementimin e rregullores së punes, pasi krejt kjo i sjell anën pozitive në punën e rregullt që lidhet direk me funksionimin e teatrit dhe kjo do sjellë më shumë shfaqje më shumë anë të mira për shoqërin tonë.

Fjalën e mori edhe një antar tjetër zot. Gani Ibrahim, me marrjen e fjalës së rastit theksoi se Muzika dhe Teatri janë një pjesë e pandashme e skenës ku krejt kjo lidhet me rregulloren e punës e cila u shpalos nga ana e Drejtoreshës zonjes Kutllofcji, jamë falenderus për anën pozitive të marrjes së kësaj detyre mjaft të fshtir por që sjellë fruta për funksionimin e Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani".

Ndërsa, në fund drejtoresha Kutllovci, ftoi të pranishmit, por edhe të interesuarit tjerë të artit që, bazuar në afatet e caktuara, idetë dhe rekomandimet t'i përcjellin edhe në adresat publike në faqen e Komunës së Podujevës.

Proces mbajtësi i takimit gjatë debatit publik lidhur me diskutimin e rregullorës së punës së këshillit drejtues të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani", në Podujevë.

### **Durim Islami – Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Nr. protokollit. 09-060/04-0038226/21  
Rruga Nuhi Gashi, Podujevë  
Datë: 10.05.2021

